**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 22.12.2000, e duke vepruar sipas kërkesës së Invalidëve të luftës të UÇK-së, dega në Gjilan, nxori këtë.

# Vendim

Shoqatës së Invalidëve të luftës të UÇK-së u lejohen mjete në lartësi prej 5000 DM.
Këto mjete i ndahen kësaj shoqate sipas kërkesës së tyre, si ndihmë momentale .
Shoqata e Invalidëve të luftës së UÇK-së këto mjete mund t'i tërheq në drejtorin për buxhet dhe Financa.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit
Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr.01 2440/00
Gjilan, 22.12.2000

Kryetari i KK- Gjilan
Lutfi Haziri

Vendimi t'i dërgohet:
Shoqatës së Invalidëve të luftës
Arkivës
Drejt. Për Buxhet dhe Financa.

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 22.12.2000, nxori këtë

# Vendim

Familjeve të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës tu ndihmohet më mjete materiale në vlerë prej 1000 DM për 24 familje.
Këto mjete ndahen sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal
Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr.01- 2441/00
Gjilan, 22.12.2000

Kryetari I KK-s
Lutfi Haziri

Vendimi t'i dërgohet:
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Arkivit

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 22.12.2000, nxori këtë:

# Vendim

Familjeve të Dëshmorëve të luftës, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, t'u ndihmohet me një ndihmë të menjëhershme në vlerë prej 1000 DM, për çdo familje.
Këto mjete do të ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit.
Me mjete do të ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit.
Me vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 01- 2461/2000 të datës 28.12.2000, kjo ndihmë u është ndarë 24 familjeve të dëshmorëve.
Me që numri i familjeve të dëshmorëve sipas shënimeve që posedojnë Trupat mbrojtëse të Kosovës është 32, atëherë ndihma materiale në vlerë prej 1000 DM, me vendim plotësues do t'u ndahet edhe 8 ( tetë) familjeve të Dëshmorëve.

Vendimi hyn ne fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës – Gjilan

Nr.01- 19/2001
Gjilan, 22.12.2000

Kryetari i KK-s
Lutfi Haziri

Vendimi t'i dërgohet :
Arkivi
Drejt. Për Buxhet dhe Financa

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 18.01.2001, e duke u bazuar në nenin 31.1 dhe në nenin 51 të Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nxori këtë.

# VENDIM

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË PËR BUXHET, FINANCA DHE INVESTIME

-I-

Emërohet z. **Zijadin Maliqi** Drejtorë i Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Investime

-II-

Drejtori i emëruar, detyrat dhe obligimet do të i kryejë në harmoni me nenin 31.2 të Rregullores, Nr. 2000/ 45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe dispozitave të Statutit të Komunës se Gjilanit.

-III-

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi I Komunës se Gjilanit

Nr. 01.717 /07
Gjilan, 18.01.2001

Kyetari i K.K Gjilan,
________________
Lutfi Haziri

Vendimi t'i dërgohet
-Të emëruarit
- Arkivës

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 16.03.2001 e duke u bazuar në nenin 19. Pika 2 të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 74 të Statutit të Komunës së Gjilanit, mori këtë:

# Vendim

MBI CAKTIMIN E LARTËSIS SË PAGESËS PËR ZËVENDËSKRYETARIN E KUVENDIT TË KOMUNËS,

-I-

Caktohet paga për Zëvendëskryetarin e Kuvendit të Komunës Z. Xhemal Hyseni në lartësi prej 640 DM në muaj.

-II-

Kompensimi nga pika 1 e këtij vendimi do të aplikohet gjatë mandatit të Zëvendëskryetarit.

-III-

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

-IV-

Ky vendim aplikohet që nga data 21.11.2000

Kuvendi i Komunës Gjilan,

Nr. 01. 1599/020
Gjilan, 16.03.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 16.03.2001, e duke u bazuar në nenin 74 të statutit të Komunës, dhe nenin 19.2, të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës mori këtë:

# Vendim

Për caktimin e kompensimit të anëtarëve të Kuvendit dhe anëtarëve të Komitetit,

I

Caktohet kompensimi për anëtarët e Kuvendit të Komunës në lartësi pre 100 DM, për një seancë ndërsa për anëtarë të komitetit në lartësi prej 50 DM, për një séance,

II

Shuma e përgjithshme mujore e kompensimit për një anëtar të Kuvendit Komunal ose të Komitetit se bashku nuk mund të kalojë lartësinë prej 200 DM.

III

Kompensimi sipas pikës I dhe II të këtij vendimi, do të aplikohet për pjesëmarrësit gjatë mandatit të tyre.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës Gjilan.

Nr.01. 1488/020
Gjlan, 16.03.2001

Kryetari KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 16.03.2001 e duke u bazuar në nenin 19, pika 2 të rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 74 të statutit të Komunës së Gjilanit, mori këtë:

# Vendim

MBI CAKTIMIN E LARËTSIS SË PAGËS PËR KRYETARIN E KUVENDIT TË KOMUNËS

I

Caktohet paga për Kryetarin e Kuvendit të Komunës Z. Lutfi Haziri në lartësi prej 700 DM në muaj.

II

Kompensimi nga pika 1 e këtij vendimi do të aplikohet gjatë mandatit të Kryetarit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim aplikohet që nga data 21.11.2000

Kuvendi i Komunës Gjilan,

Nr .01. 1598/020
Gjilan, 16.03.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u bazuar në nenin 12 ( ë) të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 16.03.2001 nxori këtë:

# Vendim

I

Lirohet nga obligimi për kontributet prej 10 % në muaj nga shuma e kontraktuar e qirasë mujore për vitin kalendarik 2001, këta qiradhënës:

1) Shoqata e pensionistëve dhe të invalidëve të punës të Kosovës dega në Gjilan.
2) Bashkësia Islame e Kosovës, këshilli I bashkësisë islame në Gjilan.
3) Teknika popullore – Shoqata për edukim teknik në Gjilan,

II

Ky vendim do të aplikohet për vitin kalendarik 2001

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për buxhet, financa dhe Investime.

Kuvendi i Komunës Gjilan.

Nr 01.1489/ 020
Gjilan, 16.03.2001

Kryetari,

______________
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 11.04.2001 e duke u bazuar në nenin 12. (g) të Statutit të Komunës nxori këtë:

# VENDIM

**Për lejimin e mjeteve për Z, Murat Bajraliun.**

I

Lejohen mjete në lartësi prej 1000 DM, për Z. Murat Bajraliun.

II

Mjetet e lejuara nga pika 1. e këtij vendimi do të përdoren për t'i mundësuar Z. Murat Bajraliun udhëtim në Gjermani, për ti dhuruar djalit të tij të sëmur veshkën.

III

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës Gjilan

Nr. 01.1897-020
Gjilan, 11.04.2001

Kryetari i KK-ës.
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 11.04.2001 e duke u bazuar në nenin 12 .(n) të Statutit të Komunës nxori këtë:

# VENDIM

## Për lejimin e mjeteve për udhëtim zyrtar në Gjermani

I

Lejohen mjete në lartësi prej 15 000 DM, për udhëtim zyrtar në Gjermani për 4 vozitës.

II

Mjetet e lejuara nga pika 1. e këtij vendimi do të përdorën për sjelljen e 4 kamionëve dhuratë nga Gjermania.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës Gjilan

Nr. 01- 1895/020
Gjilan, 11.04.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 11.04.2001, e duke u bazuar në nenin 12 (n) të statutit të Komunës nxori këtë:

# VENDIM

Për lejimin e mjeteve për familjen e Asllan Sopit

I

Lejohen mjete në lartësi prej 300 DM, për familjen e Asllan Sopit i cili gjendet në burgun e Nishit.

II

Mjetet e lejuara nga pika 1 e këtij vendimi do të përdorën për t'i mundësuar familjes që ta vizitoj djalin e tyre.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

Kuvendi i Komunës Gjilan

Nr. 01-1937/020
Gjilan, 11.04.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 11.04.2001, e duke u bazuar në nenin 12 (g) të Statutit të Komunës nxori këtë:

# VENDIM

**Për lejimin e mjeteve për përfundimin e Shkollës Fillore në Fshatin Bilinicë.**

I

Lejohen mjete në lartësi prej 10.000 DM, shkollës fillore të fshatit Bilinicë.

II

Mjetet e lejuara nga pika 1. e këtij vendimi do të përdorën për përfundimin e punimeve në shkollën e fshatit Bilinicë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës Gjilan

Nr. 01-1899/020
Gjilan, 11.04.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më datë 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 44 alineja 1 pika (a), të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
MBI BARTJEN E MEJTEVE FINANCIARE

I

Barten mjetet financiare nga:

a) Drejtoria për Administratë të Përgjithshme………………………….20.000 DM.
b) Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime…………………………..9.000 DM
c) Grupa Ekzekutive …………………………………………………….30.000DM.
d) Financimi i Partive Politike………………………………………………5.000 DM.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi destinohen për pagesën e të ardhurave personale të udhëheqësisë së Kuvendit, pagesën e mëditjeve të këshilltarëve të Kuvendit dhe anëtarëve të Komiteteve.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 01-3615/020
Gjilan, 29.06.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 29.06.2001, e duke u bazuar në nenin 12 pika(g) të Statutit të Komunës së Gjilanit nxori këtë:

# VENDIM
## PËR LEJIMIN E MJETEVE PËR SHKOLLËN FILLORE " THIMI MITKO "

I

Lejohen mjete në lartësi prej 26.228 DM për Shkollën Fillore " Thimi Mitko"

II

Mjetet e lejuara nga pika I e këtij vendimi do të përdorën për kryerjen e obligimeve ndaj kryesve të punëve në objektin e Shkollës Fillore " Thimi Mitko"

III

Mjetet nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga Buxheti i Komunës.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**Kuvendi i Komunës – Gjilan**

Nr. 01-3622/020
Gjilan, 29.06.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 2 pika (r) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR REHABILITIMIN E QENDRËS SË RINISË NË FSHATIN BRESALC

I

Ndahen mjete financiare në lartësi prej 12.500 DM për Rehabilitimin e Qendrës së Rinisë në fshatin Bresalc.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës si shtesë donacionit të IOM-it në projektin në vlerë prej 42.680.60 DM, dhe do të përdorën për kryerjen e punëve të këtij projekti.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5511/020
Gjilan, 31.08.2001

Zv. Kryetari i KK-ës
Xhemajl Hyseni

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE PËR SHKOLLËN FILLORE " SELAMI HALLAQI" – GJILAN.

I

Ndahen mjete financiare në lartësi prej 33.750 DM për Shkollën fillore " Selami Hallaqi" në Gjilan.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Komunës si shtesë donacionit të CDF-it, dhe do të përdorën për meremetimin e kulmit dhe fasadimin e objektit të Shkollës Fillore " Selami Hallaqi " në Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimi.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.5510/020
Gjilan, 31.08.2001

Zv. Kryetari i KK-ës
Xhemajl Hyseni

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë.

# VENDIM
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PROJEKTIN " DOKTOR GJILPËRA "- TEATRIT TË QYTETIT NË GJILAN.

I

Ndahen mjete financiare me lartësi prej 5000 DM, Teatrit të qytetit në Gjilan për realizimin e projektit " Doktor Gjilpëra".

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga Buxheti i Komunës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimi.

KUVENDI I KOMUNËS - GJILAN

]

Nr.01.5428/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lufti Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika ( dh ) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE PËR RRUGËN QARKORE TË FSHATIT ZHEGOC.

I

Ndahen mjetet financiare në lartësi prej 10.000 DM për furnizimin me gypa të betonit për rrugën qarkore: Pllakë e Zhegocit- Shkolla e Verbicës së Zhegocit- Terbuvc-Zhegoc-Pllakë.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga Buxheti i Komunës si shtesë donacionit të IOM-it në projektin në vlerë prej 90.000 $ ( gjatësia e trasës- 16.600m).

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës- Gjilan

Nr. 01.5435/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE DREJTORISË PËR URBANIZËM, RINDËRTIM DHE AMBIENT

I

Ndahen mjete financiare në lartësi prej 30.000 DM, Drejtorisë për urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient në Gjilan.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga Buxheti i Komunës, ndërsa Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient do të i përdorë për rrënimin dhe Zhvendosjen e objekteve të ndërtuara pa leje.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5429/10
Gjilan,31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (dh) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë.

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË REALIZIMIN E PROJEKTIT TË KANALIZIMIT NË FSH. LLADOVË

I

Ndahen mjete financiare në lartësi prej 8.700 DM, për realizimin e Projektit të kanalizimit të fshatit Lladovë.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës si shtesë donacionit të IOM-it, në realizimin e Projektit të kanalizimit të fshatit në vlerë prej 97.000 DM.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kuvendi i Komunës – Gjilan.

Nr.01.5431/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (f) të Rregullores Nr.2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
## PËR SIGURIMIN E MJETEVE PËR KATËR MËSIMDHËNËS NË SHKOLLËN FILLORE TË FSHATIT MYQIBABË

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare për rrogat e katër mësimdhënësve të cilët punojnë në Shkollën fillore të fshatit Myqibabë.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga buxheti i Komunës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.6607/020
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 3 dhe nenin 12 alineja 1 pika (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
# PËR NDARJEN E MJETEVE PËR DREJTORINË PËR NDËRMARRJE DHE SHËRBIME PUBLIKE

I

Ndahen mjete financiare në lartësi prej 17.000 DM për Drejtorinë për ndërmarrje dhe Shërbime Publike.

II

Mjete nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga Buxheti i Komunës, ndërsa Drejtorisë për ndërmarrje dhe shërbime Publike do t'i përdorë për blerjen e teknologjisë Blokazhë të Automjeteve.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 5234/01
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 6 dhe 7 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MEJTEVE PËR BASHKINVESTIM NË KOMUNËN E VITISË NË NDËRTIMIN E UËS REMNIK-LLADOVË

I

Ndahen mjete financiare me lartësi prej 7.500 DM, për bashkë investim me Komunën e Vitisë për Ndërtimin e Urës Remnik-LLadovë në projektin në vlerë prej 49.150 DM, të financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

II

Mjetet nga pika I e këtij do të ndahen nga Buxheti i Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 5427/10
Gjilan, 31.08.2001

Kryetai i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 31.08.2001, e duke u bazuar në nenin 3 dhe nenin 12 alineja 1 pika (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE PËR DREJTORINË PËR NDËEMARRJE DHE SHËRBIME PUBLIKE

I

Ndahen mjete financiare në lartësi prej 17.000 DM për Drejtorinë për ndërmarrje dhe Shërbime Publike.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga Buxheti i Komunës, ndërsa Drejtoria për Ndërmarrje dhe Shërbime Publike do t'i përdorë për blerjen e teknologjisë Blokazhë të Automjeteve.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5234/01
Gjilan, 31.08.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 28.09.2001, e duke u bazuar në nenin 129 alineja 2 të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
# PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE BUXHETORE TË PASHFRYTËZUARA NËPËR DREJTORI KOMUNALE

I

Me këtë vendim bëhet shpërndarja e mjeteve buxhetore të pashfrytëzuara nëpër Drejtoria Komunale.

II

Shuma e mjeteve buxhetore të cilat do të shpërndahen është 340.000 DM, dhe do t'u ndahen këtyre Drejtorive:

- 200.000 DM, për Drejtorinë për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient
- (për asfaltimin e rrugëve).
- 80.000 DM, për Drejtorinë për Arsim.
- 30.000 DM, për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport
- 30.000 DM, për Drejtorinë për ndërmarrje dhe Shërbime Publike.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.6173/020
Gjilan, 28.09.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më datë 28.09.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (dh ) të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (dh) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KANALIZIMIN NË FSHATIN LIVOQ I EPËRM

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 8.500 DM për realizimin e projektit të kanalizimit në fshatin Livoq I Epërm.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga Buxheti I Komunës si shtesë në projektin në vlerë prej 17.000 DMn ndërsa pjesa tjetër në lartësi prej 8.500 DM, (50%) do të sigurohen nga banorët e fshatit Livoq i Epërm.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNS – GJILAN

Nr. 01.6174/020
Gjilan, 28.09.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (f) të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR BLERJEN E DY GJENERATORËVE.

I

Me këtë vendim lejohet mjete financiare në shumë prej 40.000 DM, për blerjen e dy gjeneratorëve.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga buxheti I Komunës dhe do te përdorën për blerjen e:

1- Një gjeneratori me fuqi prej 45 KË për nevojat e Shkollës Fillore " Selami Hallaqi" – Gjilan.
2- Një gjeneratori me fuqi prej 30 KË për nevojat e Shkollës së Mesme " Mehmet Isai" – Gjilan.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.7573/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (a), (d), (h) dhe (j), të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR MATRIKULIMIN E KAFSHËVE

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumë prej 30.000 DM për matrikulimin – shenjëzimin e kafshëve shtëpiake.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen me qëllim të krijimit të kushteve për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik të qytetarëve.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe shërbime veterinere.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr.01.7399/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.2 pika (b) të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KORIN E SHKOLLËS SË MUZIKËS

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 8450 DM, Korit të Shkollës së Muzikës në Gjilan.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit dhe do të përdorën për blerjen e gardërobës për 65 anëtarë të Korit ( një komplet- veshje 130 DM).

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.7405/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.2 pika (dh) të Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja I pika (dh) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË KANALIZIMIT TË RRUGËS " R. MALA ".

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 3.400 DM për financimin e projektit të kanalizimit të rrugës " Rezhep Mala" në Gjilan.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës si shtesë në projektin në vlerë prej 6.800 DM, ndërsa pjesa tjetër prej 3.400 DM, (50%) do të sigurohen nga banorët e lagjes " Rexhep Mala".

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 7404/ 020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri.

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (dh) të rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika (dh) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR MEREMETIMIN E RRUGËS NË FSHATIN PARALLOVË

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 20.000 DM për meremetimin e Rrugës në fshatin Parallovë.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti I Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS - GJILAN

]Nr.01.7407/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke vepruar sipas kërkesës së Shoqatës së Invalidëve të Luftës të UCK-ës dega në Gjilan nxori këtë.

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 5.000 DM

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 5.000 DM për shoqatën e Invalidëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – dega në Gjilan.

II

Shuma e mjeteve të lejuara nga pika I e këtij vendimi do të ndahen nga buxheti I Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.7406/020 — Kryetari i KK-ës
Gjilan, 30.11.2001 — Lufti Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Në bazë të nenit 12 dhe të nenit 121 të Statutit të Komunës dhe nenit 39 të Rregullores 2000/45 dhe në Vështrim të rregullores 2000/45, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 31.11.2001 merr këtë:

# VENDIM
# PËR PJESMARRJEN E KOMUNËS NE PROGRAMIN PILOT NË LIDHJE ME APLIKIMIN E TATIMIT NË PRONËN E PATUNDËSHME.

I

Tatimi në pronën e patundshme do të aplikohet në tërë territorin e Komunës së Gjilanit.

II

Komuna do të jetë përgjegjëse mbi çështjen e sigurimit të personelit dhe kuadrit tjetër profesional, për implementimin e këtij tatimi, si dhe do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me ngritjen e grupeve profesionale dhe mekanizmit tjetër për ekzekutimin e këtij vendimi.

III

Shpenzimet e krijuara nga zbatimi i këtij programi do të mbulohen nga buxheti Komunal.

IV

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.7391/020 — Kryetari i KK-ës
Gjilan, 30.11.2001 — Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 21. Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 12 (dh) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË REALIZIMIN E PROJEKTIT TË KANALIZIMIT NË FSH. PASJAKË

I

Ndahen mjete financiare në lartësi prej 15.000 DM për realizimin e Projektit të kanalizimit të fshatit Pasjak.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i komunës si shtesë donacionit të OJQ CHILDRENS/ AID nga Britania e Madhe e cila në projektin prej 57.000 DM ka investuar 30.000 DM.

III

Për realizimin e këtij projekti do të kujdeset Drejtoria për Buxhet. Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.7397/020 — Kryetari i KK-ës
Gjilan, 30.11.2001 — Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.2 pika (ç) të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 2 pika ( r) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 3000 & ORGANIZATËS SË RINISË SHKOLLORE

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumë prej 3000 &, organizatës së Rinisë Shkollore në Gjilan.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës dhe do të I shërbejnë O R SH me qëllim të realizimit të pjesëmarrjes në Konferencën Ndërkombëtare të KB që do të mbahet në Universitetin e Harvardit prej datës 06.12.2001 e gjerë me 09.12.2001.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr. 01.7330/020
Gjilan, 30.11.2001

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 30.11.2001, e duke u bazuar në nenin 3.1 pika (h) dhe nenin 3 e 12 pika ( i) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR MBULIMIN ME TJEGULLA PËR 34 SHTËPI

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 86.000 DM për mbulimin me tjegulla të çative të 34 shtëpive të kategorive III A.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës, me rekomandimin e Komitetit për Banim dhe Rindërtim të cilët kanë bërë vizitat e shtëpive të shkatërruara në Komunën e Gjilanit, ndërsa tjegullat do t'u ndahen nevojtarëve sipas listës që posedon Komiteti për Banim dhe Rindërtim.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN.

Nr.01.7398/020 Kryetari i KK-ës
Gjilan, 30.11.2001 Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 28.12.2001, e duke vepruar sipas kërkesës së Shoqatës së veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-dega në Gjilan, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 5.000 DM

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 5.000 DM, Shoqatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-ës.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe zhvillimit të veprimtarisë së Shoqatës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.77/020 — Kryetari i KK-ës
Gjilan, 28.12.2001 — Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 25.01.2002, e duke u bazuar në nenin 48 alineja 3 dhe 4, nenin 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit nxori këtë:

# VENDIM
## PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2002

I

Me këtë vendim aprovohet Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin 2002 në shumë prej 3.451.767 E.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është specifikacioni i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore sipas drejtorive veç e veç të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNES – GJILAN

Nr.01. 629/020 KRYETARI
Gjilan, 25.01.2002 Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 04.10.2002, duke u bazuar në nenin 44 alineja 1 pika ( a) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# VENDIM
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SHKOLLËN FILLORE " ESAT BERISHA " – LLASHTICË

I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 8.000 E për nevojat e renovimit të jashtëm të objektit të SH. F. " Esat Berisha " në fshatin Llashticë.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi, ndahen nga Buxheti i Komunës në emër të participimit të Komunës së Gjilanit në projektin që e financon CDF-ja – Prishtinë.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.8323/020 — Kyetari i KK-ës
Gjilan, 04.10.2002 — Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 04.10.2002, duke u bazuar në nenin 44 alineja 1 pika ( a) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

## VENDIM
## MBI BARTJEN E MJETEVE FINANCIARE

I

Me këtë vendim barten mjetet financiare në lartësi prej 150.000 E, për nevojat e Drejtorisë për Arsim dhe atë:

1. 50.000 E nga pozicioni – Salla e Kuvendit
2. 100.000 E nga pozicioni – Projekte për nevoja Publike.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi, Drejtoria për Arsim sot ’I përdorë për pjesëmarrje në investimet e disa OQ dhe OJQ- ve në disa objekte Shkollore të Komunës së Gjilanit:

1. Në Sh.F. Makresh i Ultë ……………………………………………19.000 E
2. Në SH.F. Mehmet Isai, në Gjilan …………………………………..6.300 E
3. Në Sh.F. Esat Berisha në Llashticë ………………………………..8.000 E
4. Në Sh.F. në Stanishor ………………………………………………12.000 E
5. Në Sh.F. në Bresalc ( Mihir )……………………………………….65.000 E
6. Në Sh.F. në Kmetoc …………………………………………………...40.000 E

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet, financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.8026/020 Kryetari i KK-ës
Gjilan, 04.10.2002 Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 04.10.2002, duke u bazuar në nenin 44 alineja 1 pika ( a) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË SHKOLLËS FILLORE NË FSHATINË BRESALC ( MIHIR )

I

Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në lartësi prej 65.000 E, për nevojat e ndërtimit të ri të Shkollës Fillore në Bresalc ( Mihir).

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi, ndahen nga buxheti i Komunës në emër të participimit të Komunës së Gjilanit, në projektin që e financon Agjencioni Europian për Rindërtim, MLIF -3.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Arsim.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.8026/020 — Kryetari i KK-es
Gjilan, 04.10.2002 — Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 04.10.2002, duke u bazuar në nenin 3.1 pika ( dh ) të Rregullores nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenin 12 alineja 1 pika ( dh ) të Statutit të Komunës së Gjilanit, nxori këtë:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR RREGULLIMIN E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT NË FSHATIN LIVOQ I EPËRM

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 50.000 E, për realizimin e projektit të ujësjellësit në fshatin Livoq i Epërm.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga buxheti i komunës si shtesë në projektin në vlerë prej 200.000 E në të cilin projekt organizata OXFAM do të participoj me mjete financiare në lartësi prej 100.000 E, ndërsa pjesa tjetër në lartësi prej 50.000 E do të sigurohen nga banorët e fshatit Livoq i Epërm.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.8027/020
Gjilan, 04.10.2002

Kryetari i KK-ës
Lutfi Haziri.

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 08.10.2002, duke u bazuar në nenin 48 alineja 3 dhe 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit dhe me rekomandim të Komitetit për Punësim dhe Personel, nxori këtë:

**VENDIM**

I

Lejohen mjete në lartësi prej 2.249,6 €, për pagat e Latush Rexhepit, Nezir Salihut dhe Ajet Makollit për periodën Maj- Dhjetor 2002, për punë në vazhdimësi gjatë kësaj periode në konviktin e nxënësve të Shkollave të Mesme në Gjilan.

II

Lejohen mjete në lartësi 3.348 € për pagat e Selim Rashitit, Demush Rexhepit dhe Zejnullah Hysenit për periodën Janar- Dhjetor 2002, për punët në vazhdimësi gjatë kësaj periode në qendrën për punë Sociale në Gjilan.

III

Lejohen mjete në lartësi prej 1.488 € pre pagën e punëtorit Isa Azizi nga Gjilani për periodën Janar – dhjetor 2002, për punët në vazhdimësi gjatë kësaj periode në Palestrën e Sporteve " Bashkim Selishta " në Gjilan.

IV

Mjetet nga pika I, II dhe III të këtij vendimi do ë ndahen nga buxheti i Komunës dhe do të realizohen sipas kontratave që do të lidhen më të lartshënuarit për vitin kalendarik 2002 në të cilat kontrata do të parashihen të drejtat dhe obligimet reciproke në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.8034/020 — K R Y E T A R I
Gjilan, 08.10.2002 — Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 08.10.2002, në bazë të nenit 48 alineja 3 dhe 4 të Statutit të Komunës së Gjilanit si dhe duke u bazuar në rekomandimin e Komitetit për Personel dhe Punësim nxori këtë:

**VENDIM**

I

Lejohen mjete në lartësi prej 100 E në muaj në emër të kujdesit familjarë, familjes së ngushtë të punëtorit të ndjerë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

II

Mjetet nga pika I e këtij vendimi kanë të drejtë t;i realizojnë vetëm bashkëshorti –ja dhe fëmijët e të vdekurit gjatë kohës së papunësisë së tyre, që nga dita e vdekjes së punëtorit e gjerë në punësimin e njërit anëtar të familjes së ngushtë ( bashkëshortit –es ose fëmiut) ose gjerë në rregullimin e kësaj materie Ligjore të Kosovës.

III

Për rastet e sëmundjeve të punëtorit dhe mungesës nga puna mbi 15 ditë ( përjashtimisht kur parashihet më udhëzimin Administrativë 2000/2 ) vendi i punës së tij mund të zëvendësohet me punëtor tjerë me kohë të caktuar dhe kompensim adekuat gjerë në ditën e kthimit të punëtorit të rregullt në vendin e tij të punës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS- GJILAN

Nr. 01.8033/020 — K R Y E T A R I
Gjilan, 08.10.2002 — Lutfi Haziri

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 09.09.2003, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (a) të Statutit të Komunës së Gjilanit,e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# V E N D I M
# PËR
# NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 10.000€ KB "MALISHEVA"-MALISHEVË

## I

Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në lartësi prej 10.000 €, Kooperativës Bujqësore "Malisheva" në fshatin Malishevë.

## II

Mjetet nga pika I të këtij vendimi ndahen nga fondi i investimeve të Buxhetit të Komunës si shtesë për aktivizimin e qumështores "Malisheva" në Fshatin Malishevë, (blerja e ambalazhës dhe veturës për transportimin e prodhimeve të gatshme). të financuar nga HEKSI-zviceran e koordinuar nga Shoqata UMCOR.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.8622 / 07
Gjilan, më 09.09.2003

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 09.09.2003, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit,e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# V E N D I M
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 7.000€ KËSHILLIT KOMBËTAR "EKSODI 99"-MITROVICË

## I

Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në lartësi prej 7.000 €, Këshillit Kombëtar i "Eksodit 99" – Mitrovicë.

## II

Mjetet nga pika I të këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Komunës, ndërsa Këshilli Kombëtarë i "Eksodi 99"-Mitrovicë, do t'i përdorë për ngritjen e përmendores në shenjë respekti popullit që strehoi qytetarët gjatë luftës.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 8623 / 07 — K R Y E T A R I
Gjilan, më 09.09.2003 — Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 23.10.2003, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 1 pika (dh) të Statutit të Komunës së Gjilanit,e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# V E N D I M
# PËR
# NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 5.240 € PËR NDËRTIMN E URËS NË LAGJËN E SHASIVARËVE-BRESALC

## I

Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në lartësi prej 5.240 €, (50%) nga shuma e kërkuar prej 10.480€ Lagjes së Shasivarëve"-Bresalc.

## II

Mjetet nga pika I të këtij vendimi ndahen nga fondi i investimeve të Buxhetit të Komunës si shtesë për realizimin komplet të projektit "Ndërtimi i urës në Lagjën e Shasivarëve"-Bresalc, në të cilin projekt banorët e kësaj lagje participojnë me 5.000€.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Ndërmarrje dhe Shërbime Publike.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.10040 / 020 — K R Y E T A R I
Gjilan, më 23.10.2003 — Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në nenin 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 17.11.2003, nxori këtë:

# V E N D I M
# PËR
# APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2004

## I

Me këtë vendim aprovohet Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin 2004 në lartësi prej 11.104.475€.

## II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është specifikacioni i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore sipas drejtorive veç e veç të Komunës së Gjilanit.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.11624 / 020 — K R Y E T A R I
Gjilan, më 17.11.2003 — Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.12.2003, duke u mbështetur në nenin 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# V E N D I M

## I

Me këtë vendim aprovohet diferenca e të hyrave në mes të Buxhetit të planifikuar dhe atij të caktuar nga MEF, në lartësi prej 625.782 €, dhe ky ndryshim do të inkorporohet në Buxhetin e tërësishëm të aprovuar nga Kuvendi I Komunës së Gjilanit më 17.11.2003.

## II

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

## III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

## KUVENDI I MKOMUNË-GJILAN

Nr.01.11632 / 020 K R Y E T A R I
Gjilan, më 30.12.2003 Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.12.2003, duke u mbështetur në nenin 74 të Statutit të Komunës së Gjilanit e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# V E N D I M
# PËR PAGA DHE MEDITJE

**I**

Me këtë vendim, të ardhurat mujore të Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe Zëvendëskryetarit plotësues të Komunës së Gjilanit ngritën për 100 % nga shuma mujore e pranuar deri më tani.

**II**

Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit u caktohet një pagë mujore prej 100 €, që do të jetë e rregullt, ndërsa për një seancë të Kuvendit çdo anëtarë do të marrë një mëditje prej 50 €, kurse për një mbledhje të Komiteteve, anëtarët e tyre do të marrin një mëditje prej 25 €.

**III**

Anëtarëve të Komisioneve të emëruar nga Kuvendi i Komunës u takon kompensimi prej 5 € për një orë pune, ndërsa kryetarit të Komisionit i takon kompensimi prej 6 € për një orë pune.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

## KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.11630 / 020 — K R Y E T A R I
Gjilan, më 30.12.2003 — Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.12.2003, duke u mbështetur në nenin 74 të Statutit të Komunës së Gjilanit e në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nxori këtë:

# V E N D I M
# PËR PAGA DHE MEDITJE

**I**

Me këtë vendim, të ardhurat mujore të Kryetarit të Komunës së Gjilanit ngritën nga 511€ në 1022€, ndërsa të ardhurat mujore të Zëvendëskryetarit dhe Zëvendëskyetarit plotësues të Komunës së Gjilanit ngritën nga 435€ në 870€.

**II**

Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit u caktohet një pagë mujore prej 100 €, që do të jetë e rregullt, ndërsa për një seancë të Kuvendit çdo anëtarë do të marrë një mëditje prej 50 €, kurse për një mbledhje të Komiteteve, anëtarët e tyre do të marrin një mëditje prej 25 €.

**III**

Anëtarëve të Komisioneve të emëruar nga Kuvendi i Komunës u takon kompensimi prej 5 € për një orë pune, ndërsa kryetarit të Komisionit i takon kompensimi prej 6 € për një orë pune.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

## KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN

Nr.01.11630 / 020 K R Y E T A R I
Gjilan, më 30.12.2003 Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në Vendimin nr.01.1512/020, për aprovimin e Buxhetit të Komunës së Gjilanit për vitin 2004, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 20.02.2004 miraton këtë:

# V E N D I M
# PËR
# NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE

**I**

Me këtë vendim nga mjetet e Buxhetit të Komunës së Gjilanit për vitin 2004-fondi për Demokratizim, ndahen mjete financiare në lartësi prej 27.800€ për financimin e Partive Politike në Komunë e Gjilanit të cilat participojn në Kuvendin Komunal.

**II**

Mjetet nga pika **I** të këtij vendimi do t'u ndahen në proporcion me vendet që kanë në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, këtyre Degëve të Partive Politike:

- **LDK-së-Dega në Gjilan** për 23 vende, 56.10% ose **16.100.70€;**
- **PDK-së**-Dega në Gjilan për 13 vende, 31.71% ose **9.100.77€;**
- **AAK-së** Dega në Gjilan për dy vende, 4.87% ose **1.397,69€;**
- Partive politike nga radha e Komunitetit serb( **OS, DSS**, **KP)**, për tri vende 7.32% ose **2.100,84€** ;

**III**

. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime-KK Gjilan.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi ditë e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN**

Nr.01.1511/ 020
Gjilan,më 20.02.2004

Kryetari i KK-së
Lutfi HAZIRI d.v.

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në nenin 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 20.02.2004, nxori këtë:

# V E N D I M
# PËR
# APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2004

## I

Me këtë vendim aprovohet Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin 2004, në lartësi prej 11.730.257€, i specifikuar sipas kategorive buxhetore.

## II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është specifikacioni i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore sipas drejtorive veç e veç të Komunës së Gjilanit.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.1512 / 020
Gjilan, më 20.02.2004

K R Y E T A R I
Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (i) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim të datës 14.05.2004, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.07.2004, nxori këtë:

## V E N D I M
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR NDËRTIMIN E GJASHTË SHTËPIVE NË RRUGËN "A. PRESHEVA"

### I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 24.000 € për ndërtimin e gjashtë (6) shtëpive në rr. "A. Presheva"

### II

Mjetet nga pika I të këtij vendimi ndahen nga mjetet e fondit të tërmetit, në emër të participimit në projektin e financuar nga ARC-ja, ndërsa do të përdoren për ndërtimin e shtëpive të këtyre qytetarëve:

1. Shaip Ahmet. ………..45m²
2. Vedat Pajazit…………65m²
3. Muhamet Ajeti………65m²
4. Nebi Osmani…………65m²
5. Muharrem Bajrami…...65m²
6. Avdush Avdiu……….65m²

### III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime e KK-Gjilan.

### IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.5786 / 07 — K R Y E T A R I
Gjilan, më 02.07.2004 — Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në Vendimin nr.01.10244/020, të datës 21.12.2004 për aprovimin e Buxhetit të Komunës së Gjilanit për vitin 2005, Kryetari i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, bie këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE**

**I**

Me këtë vendim nga mjetet e Buxhetit të Komunës së Gjilanit për vitin 2005-fondi për Demokratizim, ndahen mjete financiare në lartësi prej 28.700€ për financimin e Partive Politike në Komunë e Gjilanit të cilat participojn në Kuvendin Komunal.

**II**

Mjetet nga pika **I** të këtij vendimi do t'u ndahen në proporcion me vendet që kanë në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, këtyre Degëve të Partive Politike:

- **LDK-së-Dega në Gjilan** për 23 vende, 56.10% ose **16.100.70€;**
- **PDK-së**-Dega në Gjilan për 13 vende, 31.71% ose **9.100.77€;**
- **AAK-së** Dega në Gjilan për dy vende, 4.87% ose **1.397,69€;**
- Partive politike nga radha e Komunitetit serb( **OS, DSS**, **KP)**, për tri vende 7.32% ose **2.100,84€** ;

**III**

. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime-KK Gjilan.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Kryetari i KK-Gjilan.

Nr.01.4769 / 020
Gjilan,më 06.07.2005

Kryetari i KK-së
Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në nenin 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 21.12..2004, miraton këtë:

# V E N D I M
# PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2005

## I

Me këtë vendim aprovohet Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin 2005, në lartësi prej 10.305.553€, i specifikuar sipas Organizatave buxhetore.

## II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është specifikacioni i të hyrave dhe shpenzimeve të Organizatave buxhetore të Komunës së Gjilanit, ku në pasqyrën e shpenzimeve buxhetore që kanë të bëjnë me ekzekutivin është paraparë edhe shuma e mjeteve prej 134.000€ në emër të subvencioneve.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryeshefi ekzekutiv dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime e KK-Gjilan.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01. 10244 / 020
Gjilan, më 21.12..2004

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (n) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Finanaca, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.02.2005. miraton këtë:

## V E N D I M
## PËR LIRIMIN NGA TAKSAT DHE SHËRBIMET KOMUNALE TË DONATORËVE QË OFROJNË DONACIONE NË KOMUNËN E GJILANIT

**I**

Me këtë vendim lirohen nga taksat dhe shërbimet komunale të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe institucionet e ndryshme financiare të cilat ofrojnë donacione ose forma të tjera të ndihmës për Komunën e Gjilanit.

**II**

Donatorët të cilët ofrojnë donacione për Komunën e Gjilanit lirohen nga këto taksa dhe shërbime komunale që ofron Komuna:

- nxjerrjen e fletëve poseduese dhe kopjeve të planit,
- lirimin nga matjet gjeodezike (krahasimin e gjendjes së re me të vjetrën),
- nxjerrjen e kopjeve të planit nëpër fshatra dhe shënimet kadastrale me izohipsa (për rregullimin e rrjetave të ujësjellësit),
- caktimin e lokacioneve për vendosjen e rezervarëve të ujësjellësit apo shpuarjen e puseve (verifikimin se është pronë komunale),
- lejet për prerjen e rrugëve apo trotuareve (me kusht që organizata ta kthej në gjendjen e mëparshme),
- dhënien e pëlqimit për leje ndërtimi dhe caktimin e komisioneve për mbikëqyrje dhe pranim teknik të projekteve të realizuara.

**III**

Lirimi nga taksat dhe shërbimet komunale sipas pikës II të këtij vendimi ka karakterin e përhershëm dhe mund të realizohet vetëm përmes Zyrtarit për projekte të KK-Gjilan.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen drejtoritë përkatëse komunale.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

Nr.01.1630 / 020 — KRYETARI
Gjilan, më 24.02.2005 — Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Në bazë të nenit 39 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, nenit 132 të Statutit të komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e vet të mbajtur më 30.06.2005, miratoi këtë

# V E N D I M
# MBI TAKSËN KOMUNALE NË QARKULLIMIN NGA PATUNDSHMËRIA DHE E DREJTA

**Neni 1.**

1.1. Me këtë vendim vihet taksa (tatimi) komunale në qarkullimin e patundshmërisë dhe së drejtës në territorin e komunës së Gjilanit.

**Neni 2.**

2.1. Qarkullimi i patundshmërisë dhe së drejtës, në kuptim të këtij vendimi, nënkuptohet bartja me kompensim e drejtës së pronësisë në patundshmëri, e drejta e patentit (licencës), e drejta në uzufrukt (frytëzim) në fryte të sendit, e drejta e servituteteve reale, e drejta në rentë, e drejta në model (mostër) dhe vula të thatë (zhigë) si dhe e drejta e pronarëve të mëparshëm në patundshmërinë e nacionalizuar dhe të konfiskuar.

**Neni 3.**

3.1. Taksa (tatimi) komunale në qarkullimin e patundshmërisë është e hyre e komunës së Gjilanit.

**Neni 4.**

4.1. Taksa (tatimi) në qarkullimin e patundshmërisë dhe së drejtës, paguhet dhe atë sipas shkallës (normës) prej **1%** në vlerën qarkulluese të patundshmërisë dhe së drejtës.

**Neni 5.**

5.1. Vlerën qarkulluese të patundshmërisë e cila shërben si baza për caktimin e taksës komunale në qarkullimin nga patundshmëria dhe e drejta, e përcakton komisioni të cilin e formon drejtori i Drejtorisë për financa dhe Investime.

**Neni 6.**

6.1. Nga taksa (tatimi) komunale në qarkullimin e patundshmërisë dhe së drejtës lirohen:

- Bashkësitë fetare të cilën shesin patundshmërinë me qëllim të ndërtimit, të rindërtimit apo të renovimit të objekteve fetare të cilat shërbejnë për shërbimet fetare, dhe
- Ndërmarrjet bujqësore, që ua shesin tokën bujqësore, qytetarit ose personit juridik, për të blerë një tokë tjetër bujqësore me qëllim të grupizimit të tokës, me kusht që shitblerja të kryhet në të njëjtën kohë.

6.2. Obliguesi i taksës (tatimit) nga alineja e përparme është i obliguar që me kërkesën për lirimin nga taksa të ofrojë (paraqesë) edhe certifikatën e organit komunal për bujqësi, që fjala është për (ose po kryhet) grupizimin e tokës bujqësore.

**Neni 7.**

7.1. Obliguesi i taksës (tatimit) në bazë të këtij vendimi është shitësi i patundshmërisë dhe së drejtës.

**Neni 8.**

8.2. Mbi zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet financa dhe Investime e komunës së Gjilanit

**Neni 9.**

9.1. Ky vendim hynë në fuqi pas tetë (8) ditëve nga dita e miratimit nga Kuvendi komunal dhe nënshkrimi i tij.

**Neni 10.**

Me këtë vendim të njoftohet Drejtori i Drejtorisë për Buxhet financa dhe investime Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim dhe arkivi i Kuvendit komunal.

## KUVENDI I KOMUNËS - GJILAN

Nr.01.4612 / 020 K R Y E T A R I
Gjilan, më 30.06.2005 Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Mbështetur në nenin 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.12.2005, miraton këtë:

# V E N D I M
# PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2006

## I

Me këtë vendim aprovohet Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin 2006, në lartësi prej 10.167.896 €, i specifikuar sipas kategorive buxhetore.

## II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është specifikacioni i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore sipas drejtorive veç e veç të Komunës së Gjilanit.

## III

Sipas këtij vendimi edhe në vitin 2006 do të vazhdohet projekti i participimit sipas të cilit komunitetet që i përmbushin obligimet 100 % do të fitojnë si shpërblim nga komuna një projekt në bazë të prioritetit të tyre (komunitetit, lagjes, fshatit etj).

## IV

Edhe në vitin 2006 do të vazhdoj projekti i participimit sipas të cilit për komunitetin që participon me mjete mbi 20 %, do të kenë prioritet në realizimin e projektit.

## V

Projektet e filluara e të cilat për shkaqe të ndryshme nuk kanë përfunduar, përfundimi i tyre do të jenë me prioritet në vitin 2006.

## VI

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i KK-Gjilan.

## VII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.10042 / 020
Gjilan, më 29.12.2005

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Mbështetur në nenin 12 alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.03.2006, miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR NDARJEN E SUBVENCIONIT TEATRIT PROFESIONIST TË GJILANIT

## I

Me këtë vendim Teatrit Profesionist të qytetit të Gjilanit i ndahet subvencioni për çdo vit kalendarik, në lartësi prej 37.500€.

## II

Ky vendim vlen derisa kuvendi nuk vendosë ndryshe, ndërsa mjetet për subvencionimin e teatrit ndahen nga Buxheti i Komunës së Gjilanit.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari, Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e KK-Gjilan.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN**

Nr.01.811 / 020 KRYETARI
Gjilan, më 30.03.2006 Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.03.2006, e duke u bazuar në nenin 12 alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit,e në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 7.000€ KËSHILLIT KOMBËTAR "EKSODI 99"-MITROVICË

## I

Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në lartësi prej 7.000 €, Këshillit Kombëtar "Eksodi 99" – Mitrovicë.

## II

Mjetet nga pika **I** të këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Komunës, ndërsa Këshilli Kombëtarë i "Eksodi 99"-Mitrovicë, do t'i përdorë për ngritjen e përmendores në shenjë respekti popullit që strehoi qytetarët gjatë luftës.

## III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në lartësi prej 7.000€, Këshillit Kombëtarë "Eksodi 99"-Mitrovicë, nr.01.8623/07 i datës 09.09.2003.

## IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari,Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

## V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.808 / 020
Gjilan, më 30.03.2006

K R Y E T A R I
Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Mbështetur në nenin 12 alineja 2 pika (p) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe në bazë të Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.03.2006, miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR NDARJEN E SUBVENCIONIT TEATRIT PROFESIONIST TË GJILANIT PËR VITIN 2006

**I**

Me këtë vendim Teatrit Profesionist të qytetit të Gjilanit i ndahet subvencioni për vitin 2006 në lartësi prej 37.500€.

**II**

Mjetet nga pika I e këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Komunës së Gjilanit.

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari, Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e KK-Gjilan.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN**

Nr.01.811 / 020
Gjilan, më 30.03.2006

KRYETARI
Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.04.2006, e në bazë të kërkesës së Zyrës së Agjencionit për Demokraci Lokale në Gjilan, miratoi këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDARJEN E NJË SUBVENNCIONI VJETOR NË LARTËSI PREJ 3000€ ZYRËS SË AGJENCIONIT PËR DEMOKRACI LOKALE NË GJILAN**

**I**

Me këtë vendim nga Buxheti i Komunës së Gjilanit, Zyrës së Agjencionit për Demokraci Lokale në Gjilan i ndahet një subvencion për vitin 2006, në lartësi prej 3000€.

**II**

Lartësinë e mjeteve sipas pikës **I** të këtij vendimi, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ia ndan Zyrës së Agjencionit për Demokraci Lokale në Gjilan për të mbështetur aktivitetin e saj.

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-së dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

Nr.01.1093 / 020
Gjilan, më 27.04.2006

KRYETARI
Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Në bazë të nenit 2 paragrafi 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nenit 13 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e vet, të mbajtur më 02.07.2004 miraton këtë

# *RREGULLORE*

## PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

I. Dispozitat e përgjithshme
Qëllimi

**Neni 1**

1.1. **Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e prodhimtarisë, ndërtimtarisë, tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Gjilanit, në bazë të nevojave dhe kërkesave të punonjësve dhe q**ytetarëve.

**Neni 2**

2.1. **Të gjitha subjektet afariste të themeluara dhe të regjistruara në pajtim me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 për Shoqëritë Tregtare : Bizneset individuale, shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë aksionare ose shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë Rregullore.**

**Neni 3**

3.1. **Orari i punës nënkupton periudhën kohore ( fillimin dhe mbarimin ).**

3.2. **Orari i fillimit dhe mbarimit të punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Duhet caktuar orarin e punës para dite dhe pas dite, si dhe ditët që nuk punohet.**

II. Koha e punës

**Neni 4**

4.1. **Orari i punës në intervalin kohor është më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore fillon prej 01.04. dhe zgjatë deri më 30.09. të vitit,**

b) **Në periudhën dimërore fillon më 01.10. dhe zgjatë deri më 31.03 të vitit.**

**Neni 5**

5.1**. Orari i punës i dyqaneve zejtare fillon prej orës 08.00. deri më 18.00**

5.2. **Furrat e bukës do të punojnë çdo ditë prej orës 04.00. deri më 22.00**

5.3. **Pjelltoret dhe qebaptoret do të punojnë çdo ditë prej orës 06.00 deri në ora 21.00.**

5.4. **Përjashtimisht nga paragrafi 5.2 i këtij neni në ditën e vikendit ( e diel ) dhe të festave, orarin e punës do ta caktoj DEM sipas nevojës së qytetarëve ( sistem të kujdestarisë ).**

**Ditën e vikendit ( e diel ) dyqanet zejtare nuk punojnë, përveç salloneve të ondulimit.**

**Neni 6**

6.1. **Orari i punës i vetëshërbimeve, supermarketeve dhe dyqaneve tregtare është më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës 07.00. deri në ora 21.00**
b) **Në periudhën dimërore prej orës 08.00. deri në ora 19.00**

6.2. **Përjashtimisht nga paragrafi 6.1. i këtij neni në ditën e vikendit ( e diel ) dhe të festave, orarin e punës do ta caktoj DEM sipas nevojës së qytetarëve ( sistem të kujdestarisë ).**

**Neni 7**

7.1. **Orari i punës i depove të artikujve ushqimor dhe joushqimor është më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës 08. deri në ora 19.00.**
b) **Në periudhën dimërore prej orës 08.00. deri në ora 18.00.**

7.2. **Ditën e vikendit ( e diel ) dhe të festave nuk punojnë.**

7.3. **Ndërmarrjet ndërtimore ( ndërtimi i ulët dhe i lartë ) ju ndalohet puna për vikend ( e diellë ) dhe festave zyrtare.**

**Neni 8**

8.1. **Orari i punës i hoteleve, moteleve, restoranteve, pansioneve dhe kampeve është më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës 07. deri në ora 24.00.**
b) **Në periudhën dimërore prej orës 07. deri në ora 24.00.**

8.2. **Përjashtimisht nga paragrafi 8.1. mund të punojnë më gjatë se orari i punës vetëm në rastet e organizimeve shoqërore ( dasmave familjare, festë ose ndonjë aheng tjetër të ngjashëm) por jo më shumë se në ora 03 e mëngjesit. Lidhur me këtë duhet kërkohet leja e veçantë nga DEM-ja. Për leje duhet paguar në bazë të metrit katror të lokalit. Lokali deri në 100m$^2$ për çdo metër paguan nga** 0.70€ **për** m$^2$ **mbi** 100m$^2$ **nga** 1.00€ për m$^2$.

8.3. **Veprimtaritë e lartpërmendura në paragrafin 1.1 të këtij neni pas orës 24.00 nuk iu lejohet shërbimi i mysafirëve jashtë objektit.**

**Neni 9**

9.1. **Orari i punës i kafe – bareve, internet – kafeve, disko – klubeve është më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës 20.00 deri në ora 24.00**
b) **Në periudhën dimërore prej orës 19.00. deri në ora 23.00**

Neni 10

10.2. **Orari i punës për klubet e natës është më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës** 23.00 **deri në ora** 05.00
b) **Në periudhën dimërore prej orës** 23.00 **deri në ora** 05.00

10.2. **Për klubet e natës kërkohet leje e veçantë nga DEM-ja e cila lëshohet përkohësisht për 3 muaj. Njëherit edhe nga organet e policisë duhet të ketë leje për ta zhvilluar këtë veprimtari. Për leje duhet paguar** 1.00 € **për** $m^2$

**Neni 11**

11.1. **Veprimtaritë e parapara në nenin 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje, gjatë orarit të punës nuk mund t`ua prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të tyre, në asnjë formë.**

Neni 12

12.1. **Orari i punës për tregjet e qytetit dhe lokaliteteve është më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës 05.00 deri në ora 19.00.**
b) **Në periudhën e dimrit prej orës 07.00 deri në ora 18.00.**

12.2. **Tregu i gjelbër është ditën e shtunë por është i hapur edhe ditëve të tjera të punës, përveç ditës së vikendit ( e diel ).**

12.3. **Tregu i kafshëve, dhe i automjeteve punojnë vetëm ditën e shtunë.**

12.4. **Në Zhegër tregu i gjelbër dhe i kafshëve punon të hënën sipas orarit të njëjtë për tregun e qytetit.**

**Neni 13**

13.1. **Në objektet hoteliere të cilat gjenden në afërsi prej** 100 metra **nga objektet e banimit e në të cilat organizohet program i gjallë muzikor apo me audio – video mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mund të mbahet pas orës** 24.00.

**Neni 14**

14.1. **Orari i punës për shitjen e karburanteve do të jetë më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës 06.00 deri në ora 24.00**
b) **Në periudhën dimërore prej orës 06.00 deri në ora 24.00**

14.2. **Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni së paku dy ( 2 ) pika të shitjes do të kujdestarojnë non – stop 24 orë. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojnë DEM-ja në bashkë koordinim me subjektet të cilat merren me shitjen e karburanteve. Orari do të hartohet për një ( 1 ) muaj dhe do t`i dorëzohet inspekcionit të tregut.**

**Neni 15**

15.1. **Orari i punës për barnatoret do të jetë më sa vijon :**

a) **Në periudhën verore prej orës 08.00 deri në ora 20.00**
b) **Në periudhën dimërore prej orës 08.00 deri në ora 19.00**

15.2. **Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni dy ( 2 ) barnatore do të punojnë** non - stop 24 orë**. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojë DEM-ja në bashkë koordinim me**

**barnatoret. Orari do të hartohet për një (1 ) muaj dhe do t`i dorëzohet inspekcionit të tregut për muajin vijues.**

15.3. **Orari i kujdestarisë do të caktohet sipas alfabetit të mbishkrimeve të subjekteve afariste, dhe të gjitha subjektet afariste kanë për obligim që të vendosin orarin e kujdestarisë.**

**Neni 16**

16.1. **Subjektet afariste mund të zgjasin orarin e punës me rastin e festave më sa vijon :**

a) **Për festën kombëtare 28 Nëntori, deri në orën 01.00.**
b) **Për festat fetare deri në ora 01.00.**
c) **Për festën e gruas 8 Marsi, deri në ora 01.00.**
d) **Për festën e Shën Valentinit, deri në ora 01.00.**
e) **Për festën e Vitit të Ri, deri në ora 01.00.**
f) **Për ditën e Çlirimit të Gjilanit deri në ora 01.00.**

16.2. **Për të gjitha këto raste të parapara me paragrafin 1 të këtij neni nuk duhet të paguhet taksa shtesë dhe tarifa komunale.**

III. Dispozitat ndëshkuese

**Neni 17**

**17.1.** Të gjitha subjektet afariste do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 4,5,6,7,8,9,10,12, 14 dhe 15 të kësaj rregulloreje dhe atë :

**a)** Personat juridik prej,………………………………. **200 - 300 €**
b) Personat fizik prej,………………………………… **100 - 150 €**

**Neni 18**

**18.1.** Të gjitha subjektet afariste do të gjobiten për kundërvajtje në qoftë se konstatohet se kanë zgjatur orarin e punës pa pëlqimin dhe vendimin e Drejtoratit për Ekonomi dhe menaxhment dhe atë :

**a)** Personat juridik prej ,…………………………………**150 - 250 €**
**b)** Personat fizik prej,………………………………… **100- 200 €**

**III. Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

**Neni 19**

**9.1.** Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset; Drejtorati për Ekonomi dhe Menaxhment, ndërsa mbikëqyrjen do ta bëjë Organi administrativ kompetent për inspekcion - sektori i inspekcionit të tregut dhe policia.

**Neni 20**

**20.1.** Të gjitha subjektet afariste, janë të obliguar që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregulloreje, në afatin prej tetë ( 8 ) nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

**Neni 21**

**21.1.** Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet vendimi nr. **01/8028/020** i dt. **04.10.2003** mbi caktimin e orarit të punës të objekteve afariste të cilat ushtrojnë veprimtarinë tregtare me pakicë dhe të objekteve të cilat ofrojnë shërbime shërbyese – hoteliere.

**Neni 22**

**22.1.** Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT**

Nr.01.5796 / 020 — K R Y E T A R I
Gjilan, më 02.07.2004 — Lutfi HAZIRI

**KOMUNA E GJILANIT**

**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Duke u mbështetur në nenin 12 alineja 1 pika (g) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe pas shqyrtimit të Rekomandimit të Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 03.10.2006, miratoi këtë:

## V E N D I M
## PËR LEJIMIN E MJETEVE PËR TRANSPORTIN E NXËNËSVE UDHËTARË

### I

Me këtë vendim lejohen mjete nga buxheti i Komunës së Gjilanit për transportin e nxënësve udhëtarë që gravitojnë prej viseve rurale për të kryer shkollimin e mesëm.

### II

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Investime dhe Drejtoria për Arsim e KK-Gjilan, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari dhe Kryeshefi ekzekutiv i KK-së- Gjilan.

### III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS - GJILAN**

Nr.01.5709 / 0101
Gjilan, më 03.10.2006

KRYETARI,
Xhemajl HYSENI

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Në bazë të nenit 129 dhe 130 dhe 131 të Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 03.10. 2006 miraton këtë:

# V E N D I M

## PËR LEJIMIN E TEJKALIMIT TË MJETEVE BUXHETORE NË POZICIONIN E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE NË BUXHETIN E VITIT 2006 NGA TË HYRAT VATANAKE

**I**

Me këtë vendim lejohet tejkalimi i mjeteve buxhetore në pozicionin e mallrave dhe shërbimeve në buxhetin e vitit 2006 nga të hyrat vatanake.

**II**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet Financa dhe Investime e dhe kryeshefi i ekzekutiv i KK Gjilanit.

**III**

Me këtë vendim të njoftohen organet kompetente të Pushtetit Qendrorë përkatësisht MEF-i.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.5711 / 0101
Gjilan, 03.10.2006

Kryetari i KK-së
____________________
Xhemajl Hyseni

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Në bazë të nenit 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 03.10. 2006 miraton këtë:

# V E N D I M

## PËR BARTJEN E MJETEVE PREJ NJË KODI BUXHETOR NË KODIN TJETËR BUXHETOR TE KATEGORIA E INVESTIMEVE KAPITALE

I. Miratohet rekomandimi i Komitetit për Politikë dhe Financa i KK Gjilanit për bartjen e mjeteve prej një kodi buxhetor në kodin tjetër buxhetor te kategoria e investimeve kapitale.

II. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet Financa dhe Investime e dhe kryeshefi i ekzekutiv i KK Gjilanit.

III. Me këtë vendim të njoftohen organet kompetente të Pushtetit Qendrorë përkatësisht MEF-i.

IV. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr.01.5710 / 0101
Gjilan, 03.10.2006

Kryetari i KK-së
__________________
Xhemajl Hyseni

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Në bazë të nenit 129 dhe 130 të Statutit të Komunës së Gjilanit, dhe të rekomandimit të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 03.10.2006 miraton këtë:

## V E N D I M
## PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2007

**I**

Me këtë vendim aprovohet Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin 2007, në lartësi prej **11.035.194,00** euro, i specifikuar sipas kategorive buxhetore.

**II**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është specifikacioni i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore sipas drejtorive veç e veç të Komunës së Gjilanit.

**III**

Sipas këtij vendimi edhe për vitin 2007 do të vazhdoi projekti i participimit të komunitetit.

**IV**

Komuniteti që merr pjesë në participim të projektit prej **30%** të vlerës së përgjithshme dhe të cilët kanë kryer obligimet për taksën në pronë e fitojnë të drejtën automatikisht në realizimin e projektit të tyre me prioritet.

**V**

Pjesë e këtij vendimi është edhe realizimi i projekteve të mbetura nga viti paraprak (2006).

**VI**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-Gjilan

**VII**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit

**KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT**

Nr.01/5708/0101
Gjilan, 03.10.2006

Kryetari i KK-së
__________________
z. Xhemajl Hyseni

Duke u bazuar në rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe bazuar në kërkesën e Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në Gjilan, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.04.2008, miratoi këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 3.000€, ORGANIZATËS KOMUNALE TË PENSIONISTËVE DHE INVALIDËVE TË PUNËS NË GJILAN**

**I**

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 3.000€, Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në Gjilan.

**II**

Mjetet financiare nga pikën **I** të këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit, përderisa Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në Gjilan obligohet që më parë të sjell dëshmitë për shfrytëzimin e këtyre mjeteve para organeve komunale.

**III**

Burimet e financimit i përcakton Drejtoria e financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me sektorët tjerë.

**IV**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

**Nr.01.3744 / 0101**
**Gjilan, më 16.4.2008**

**Kryetari i komunës,**
**_________________**
**/Qemajl MUSTAFA/**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe në kërkesën e Shërbimit Policor të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.04.2008, miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BLERJEN E PAISJEVE PËR NEVOJAT E SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS

## I

Me këtë vendim ndahen mjete financiare për blerjen e pajisjeve për nevojat e Shërbimit Policor të Kosovës-Stacionit Policor në Gjilan.

## II

Mjetet e lejuara sipas këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Komunës së Gjilanit për blerjen e këtyre pajisjeve:

1. Pesë (5) foto kamera digjitale,
2. Tre (3) kompjuterë për zyre të intervistimit me pajisje komplete,
3. Një (1) printeri me ngjyra për Njësinë e Hetimeve Kriminale,
4. Një metri (gjatësi 50 m) për matje të ndryshme në aksidente/incidente,
5. Mbulimin e shpenzimeve të një darke modeste në shenjë mirënjohje për angazhimin e policisë në ditën e Shpalljes së Pavarësisë.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

## KUVENDI I KOMUNËS – GJILAN

Nr.01.3742 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008

Kryetari i komunës,
________________
/Qemajl MUSTAFA/

Duke u bazuar në nenin 3.2 pika (b), (c) dhe (d) të Rregullores nr.2007/30 për ndryshimin e Rregullores nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, si dhe duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.04.2008, miratoi këtë;

## V E N D I M
## PËR NDARJEN E SUBVENCIONIT TEATRIT PROFESIONIST TË GJILANIT

**I**

Me këtë vendim Teatrit Profesionist të Gjilanit i ndahet subvencioni për vitin kalendarik 2008 në shumën prej **66.200€.**

**II**

Mjetet si në pikën **I** të këtij vendimi, Teatrit Profesionist të Gjilanit i ndahen nga Buxheti i Komunës, ndërsa Teatri do t'i shfrytëzoi për funksionimin normal të tij, përderisa shpërndarja e mjeteve do të bëhet si në vijim:

**1**. Për pagat mujore të tetë (8) punëtorëve teknik …………..............**12.480€,**
**2**. Për pagat mujore të nëntë (9) aktorëve…………………..............**17.604**€,
**3**. Për pagat mujore të njëmbëdhjetë (11) aktorëve
të rinj që pritet të punësohen............................................ ..............**17.930€**
**4**. Për nevojat e udhëtimit në festivale të ndryshme,
apo udhëtime për realizimin e shfaqjeve.............................................**3.186**€,
**5**. Për realizimin e së paku tri projekteve
(projekte të diplomës për student të regjisë dhe aktrimit....................**15.000€.**

**III**

Mjetet financiare si në pikën **I** të këtij vendimi do të barten në llogari të Teatrit Profesionist të Gjilanit, varësisht nga Plani dinamik i realizimit të projekteve.

**IV**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, ndërsa aplikohet nga data 01.01.2008.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

Nr.01.3738 / 0101
Gjilan, më 16.04.2008

Kryetari i Komunës,

__________________
/Qemajl MUSTAFA/

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486


Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, e në bazë të kërkesës së Zyrës së Agjencionit për Demokraci Lokale në Gjilan, miratoi këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDARJEN E NJË SUBVENCIONI VJETOR NË LARTËSI PREJ 3000€ ZYRËS SË AGJENCIONIT PËR DEMOKRACI LOKALE NË GJILAN**

**I**

Me këtë vendim nga Buxheti i Komunës së Gjilanit, Zyrës së Agjencionit për Demokraci Lokale në Gjilan i ndahet një subvencion për vitin 2008, në lartësi prej 3000€.

**II**

Lartësinë e mjeteve sipas pikës **I** të këtij vendimi, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ia ndan Zyrës së Agjencionit për Demokraci Lokale në Gjilan për të mbështetur aktivitetin e saj.

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria e financave, ekonomisë dhe zhvillimit e KK-Gjilan..

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

**01.Nr.___5479______**
**Gjilan, më 05.06.2008**

**Kryetari i Komunës,**
**_________________**
**/Qemajl MUSTAFA/**

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar nenin 38.2 pika (f) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

**V E N D I M**
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 6.000€, PËR PËRFUNDIMIN E PUNIMEVE TË MEMORIALIT “FATOS LIMANI” NË FSHATIN POGRAGJË**

**I**

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 6.000€, për përfundimin e punimeve të Memorialit “Fatos Limani” në fshatin Pogragjë, sipas projektit të dorëzuar në Komunën e Gjilanit nga Këshilli organizativ i banorëve të fshatit Pogragjë.

**II**

Mjetet financiare nga pikën **I** të këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit, përderisa Këshilli organizativ për ndërtimin e Memorialit i fshatit Pogragjë obligohet që më parë të sjell dëshmitë për shfrytëzimin e këtyre mjeteve para organeve komunale, ndërsa burimet e financimit i përcakton Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me sektorët tjerë.

**III**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

**01.Nr.____5475_____**
**Gjilan, më 05.06.2008**

**Kryetari i komunës**
**____________________**
**/Qemajl MUSTAFA/**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Adresa:rr."Adem Jashari" pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar nenin 40 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 16.05.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË LARTËSI PREJ 2.000€, SHOQATËS NDËRKOMUNALE TË VERBËRVE DHE ME TË PAMË TË DOBËSUAR

**I**

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 2.000€, Shoqatës Ndërkomunale të verbërve dhe me të pamë të zvogëluar në Gjilan.

**II**

Mjetet financiare nga pikën **I** të këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit, përderisa Shoqata Ndërkomunale e të verbërve do t'i shfrytëzoi për zhvillimin e aktivitetit të vet bazuar në Planin bazik të Shoqatës për vitin 2008, dhe para organeve komunale obligohet që më parë të sjell dëshmitë për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

**III**

Burimet e financimit i përcakton Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me sektorët tjerë.

**IV**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

**01.Nr.____5476______** **Kryetari i komunës**
**Gjilan, më 05.06.2008**
**_________________**
**/Qemajl MUSTAFA/**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 05.06.2008, duke u bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Komunitete, miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BASHKFINANCIM NË PROJEKTET E INFRASTRUKTURËS NË FSHATIN PASJAN DHE KORETISHTË

**I**

Me këtë vendim Komuna e Gjilanit ndanë mjete financiare në emër të bashkëfinancimit në projektet e infrastrukturës me qëllim të krijimit të kushteve për kthim dhe riintegrim të sigurt dhe të qëndrueshëm të minoriteteve, projekte këto të Mercy Corps-it/programi i USAID-it, dhe atë si vijon:

1. **Në projektin e ndërtimit të fushës së sportit në fshatin Pasjan** ndahen mjete financiare në lartësi prej 4.000,00€,
2. **Në projektin e ndërtimit të Qendrës së Kulturës në fshatin Koretishtë** ndahen mjete financiare në lartësi prej 3.000,00€.

**II**

Mjetet financiare nga neni I, pika 1 dhe 2 të këtij vendimi ndahen nga Buxheti i Komunës së Gjilanit.

**III**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e financave, ekonomisë dhe zhvillimit dhe Zyra për projekte, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

01.Nr.__5480_______ 
Gjilan, më 05.06.2008

Kryetari i Komunës,
________________
/Qemajl MUSTAFA/

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.06.2008, si dhe duke u bazuar në kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, miratoi këtë:

## V E N D I M
## PËR RIDESTINIMIN E PROJEKTEVE

**I**

Me këtë vendim bëhet ridestinimi i këtyre projekteve:

1. Ndërtimi i shkollës në Lagjen “Qarku”.................230.000.00€
2. Projekte të papërfunduara nga viti paraprak.............35.785.00€
3. Zgjerimi i hapësirës për varreza të qytetit................10.000.00€
4. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve...............................30.000.00€

305.785.00€

**II**

Projektet si në pikën I të këtij vendimi ridestinohen në Kodin e projektit 68490- dhe do të shfrytëzohen për participim në projektet me donatorë dhe komunitete.

**III**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

01.Nr.____6169_____
Gjilan, më 24.06.2008

Kryetari i komunës,
_______________
/Qemajl MUSTAFA/

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar nenin 38.2 pika (f) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe pas shqyrtimit të kërkesës së SHLD të UÇK-së, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.07.2008, miratoi këtë:

**V E N D I M**
**Për mbulimin e shpenzimeve financiare në ngritjen dhe vendosjen e pllakave përkujtimore**

**I**

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 3980 €, për mbulimin e shpenzimeve në ngritjen dhe vendosjen e pllakave përkujtimore për të gjithë dëshmorët e Komunës së Gjilanit.

**II**

Mjetet financiare nga pikën **I** të këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit, përderisa të njëjtat do të paguhen në xhirollogarinë e P.Z. “MËRGIMI”, nr.1150126351000132 në Pro Credit Bank, pas ofrimit të dëshmive të nevojshme.

**III**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

**01.Nr.____6544_____** — **Kryetari i komunës**
**Gjilan, më 04.07.2008**

**__________________**
**/Qemajl MUSTAFA/**

Adresa:rr."Adem Jashari" pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar nenin 38.2 pika (b) të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe pas shqyrtimit të kërkesës së Punëtorisë së pavarur "Foto-Fari", Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 04.07.2008, miratoi këtë:

**V E N D I M**
**Për ndarjen mjeteve financiare në lartësi prej 4980€, PP "Foto Fari" nga Gjilani**

**I**

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 4980,00 €, për mbulimin e shpenzimeve për 332 fotografi artistike për historikun e Komunës së Gjilanit, të formatit 30x40cm, me çmim prej 15,00 për një fotografi të punuara nga Punëtoria e Pavarur "Foto Fari" nga Gjilani.

**II**

Mjetet financiare nga pikën **I** të këtij vendimi ndahen nga buxheti i Komunës së Gjilanit, përderisa të njëjtat do të paguhen në xhirollogarinë e P.P. "Foto Fari", nr.1150126867000168 në Pro Credit Bank, pas ofrimit të dëshmive të nevojshme.

**III**

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

**KUVENDI I KOMUNËS-GJILAN**

**01.Nr.____6545_____**
**Gjilan, më 04.07.2008**

**Kryetari i komunës**
**_________________**
**/Qemajl MUSTAFA/**

REPUBLIKA E KOSOVËS
